



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 476, datë 6.5.2009

P Ë R

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË KONTRATËN E
KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM, OPERIM,
TRANSFERIM), TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË
EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE “HASI
ENERGJI”, SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE
“LENGARICA 1” DHE “LENGARICA 2”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006, “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në kontratën e koncesionit, të formës “BOT” (Ndërtim, Operim, Transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe “Hasi Energji”, shpk, për ndërtimin e hidrocentraleve “Lengarica 1” dhe “Lengarica 2”, të miratuar me vendimin nr.543, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

**MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**



GENC RULI



MARREVESHJE

PER

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE KONTRATEN E KONCESIONIT TE FORMES "BOT" (Ndertim, Operim, Transferim) TE LIDHUR NDERMJET MINISTRISE SE EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES DHE SHOQERISE "HASI ENERGJI" SHPK, PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALEVE "LENGARICA 1" DHE "LENGARICA 2", TE MIRATUAR ME VKM NR.543, DATE 01.05.2008.

Ne Tirane, sot me date 25.04. 2009, palet:

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes percaktuar si "AUTORITET KONTRAKTUES" me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.136, date 14.03.2007 "Per percaktimin e autoritetit kontraktues per ndertimin me koncesion te hidrocentraleve "Lengarica 1" dhe "Lengarica 2", qe me poshte do te quhet i tille, perfaqesuar nga Titullari, z. Genc Ruli, i datelindjes _____, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi _

DHE

Shoqeria "Hasi energji" Sh.p.k., rregjistruar si person juridik me vendimin nr. 35241, date 20.03.2006, te Gjykates se Rrethit Tirane, qe me poshte do te quhet "Koncesionari", perfaqesuar nga administratori Z. Hasan LEKA, _____, i datelindjes _____ dhe banues ne _____ Rruga "Naim Frasheri" Nr. 4/, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, bien dakord si me poshte:

Te lidhin kete Marreveshje, per disa shtesa dhe ndryshime ne kontraten e koncesionit te formes BOT, te lidhur ndermjet Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes dhe Shoqerise "Hasi Energji" shpk, per ndertimin e hidrocentraleve "Lengarica 1" dhe "Lengarica 2", te miratuar me VKM nr.543, date 01.05.2008.

Hyrje

Duke pasur parasysh qe:

- ❖ Shoqerise "Hasi Energji" sh.p.k. (Koncesionari), gjate hartimit te projekzbatimit te objektit, te miratuar me VKM Nr.543, date 01.05.2008, i rezultuan zgjidhje me te leverdisshme tekniko-ekonomike per ndertimin e HEC-ve "Lengarica 1" dhe "Lengarica 2", si :
 - Reduktim i numrit te HEC-ve nga dy hidrocentrale: "Lengarica 1" dhe "Lengarica 2", qe parashikonte projekti i miratuar me pare, me VKM Nr.543, date 01.05.2008, ne nje hidrocentral: "Lengarica";

- ❖ Forma e koncesionit nuk ndryshon, pra mbetet BOT; treguesit kryesore teknike, si fuqia dhe prodhimi vjetor, permiresohen, duke e bere kete koncesion te leverdisshem.
- ❖ O.SH.A., bazuar ne projektin e ri eshte e interesuar per zbatimin e ketij projekti nga ana e koncesionarit, sepse perfitimi eshte me i larte, si per koncesionarin ashtu edhe per vendin.

Palet bien dakord qe ne kontraten baze te koncesionit, te miratuar me VKM Nr 543, date 01.05.2008, te behen keto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Ne kontraten baze te koncesionit, te miratuar me VKM Nr 543, date 01.05.2008:

- kudo ku eshte shprehur "...hidrocentralet /eve" "Lengarica 1" dhe "Lengarica 2", zevendesohet me "...hidrocentrali/n/t "Lengarica".
- kudo ku eshte shprehur "...sipas aneksit 1, bashkelidhur kontrates", zevendesohet me "...sipas aneksit 1 bashkelidhur kesaj marreveshjeje."
- kudo ku eshte shprehur "...sipas aneksit 2, bashkelidhur kontrates", zevendesohet me "...sipas aneksit 2 bashkelidhur kesaj marreveshjeje."

Neni 2

Ne nenin 1 "*Perkufizime*":

- Ne piken 1.4, fjalet "...qe ne rastin konkret eshte Hidrocentraleve Lengarica 1 dhe Lengarica 2, komuna Petran, rrethi Permet, me fuqi te instaluar per "Lengarica 1" 3700 kW dhe "Lengarica 2" 2500 kW, per prodhim te energjise elektrike per 14,200,000 kW/h dhe 21,500,000 kW/h," zevendesohen me fjalet "...qe ne rastin konkret eshte Hidrocentrali "Lengarica", komuna Petran, rrethi Permet, me fuqi te instaluar 8,906 kW, per prodhim te energjise elektrike prej 36,000,000 kW/h,".

Neni 3

Ne nenin 4 "*Te drejtat dhe detyrimet e autoritetit kontraktues*":

- Paragrafi sipas pikes 4.2, zevendesohet me paragrafin "*Te miratoje projektin e zbatimit te hidrocentralit, te pergatitur nga vete koncesionari.*".

Neni 4

Ne nenin 5 "*Detyrimet dhe te drejtat e koncesionarit*":

- Ne piken 5.2, fjalet "...nga data e miratimit te projektit te zbatimit", zevendesohen me fjalet "...nga data e leshimit te lejes se ndertimit".
- Ne piken 5.5, fjalet "...sipas afateve ne kete kontrate", zevendesohen me fjalet "...sipas afateve ne kete marreveshje".
- Paragrafi sipas pikes 5.12, zevendesohet me paragrafin "*Te paraqese prane Autoritetit kontraktues, per miratim projektin e zbatimit brenda gjashte muajve nga hyrja ne fuqi e kesaj marreveshjeje.*".

- Ne piken 5.13, fjalet "...me fuqi te vendosur prej 6200 kW", **zevendesohen** me fjalet "...me fuqi te vendosur prej 8,906 kW."

Neni 5

Ne nenin 6 "*Vleresimi i nvestimeve*", permbajtja e tij ndryshon si me poshte:

"Mbi bazen e te dhenave te projektit, investimet qe duhet te kryhen nga koncensionari per hidrocentralin "Lengarica" jane ne vleren totale, jo me pak se 1,908,714,000 (njemiliard e nenteqindetetemilion e shtateqindekatermbedhjetemije) leke, te ndara sipas aneksit 1 bashkelidhur kesaj marreveshjeje.

Neni 6

Ne nenin 7 "*Programi i punimeve*":

- Ne piken 7.1, fjalet "...brenda 36 (tridhjetegjashte) muajve nga marrja e lejes se ndertimit.", **zevendesohet** me "...brenda 36 (tridhjetegjashte) muajve nga hyrja ne fuqi e kesaj marreveshjeje"

Neni 7

Ne nenin 18 "*Sanksionet*":

- Ne piken 18.3, fjalet "...te prodhimit te energjise elektrike prej 35.7 milion kWh/vit.", **zevendesohen** me fjalet "...te prodhimit te energjise elektrike prej 36 milion kWh/vit,

Neni 8

Ndryshimet dhe shtesat e percaktuara ne kete marreveshje hyjne ne fuqi me nenshkrimin e saj nga palet dhe pas miratimit nga Keshilli i Ministrave te Republikes se Shqiperise.

Nenet e tjera te kontrates baze nuk kane ndryshuar.

Marreveshja hartohet ne 5 (pese) kopje dhe nenshkruhet pa verejtje nga te dy palet.

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomise,
Tregtise dhe Energjetikes

Perfaqesuar nga

z. GENC RULLI

KONCESIONARI

Shoqeria "Hasi Energy" Shpk

Perfaqesuar nga

z. HASTI DEKA